REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MIMOZA SADUSHAJ
ADRESA Rruga Vaso Pasha, pallati 13/1
Tirane
TEL: 0692097547

# REDAKTIM DHE VËRTETIM I AKTEVE TË SH.P.K-VE

**Nr. repertori: 5102** **Nr. koleksioni: 1977**

**Tirane më 30/09/2024**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

A2024053540199042695

*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë

A2024053540199042695

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA E NOTERISË TIRANË**
**Nr.** 5102 **Rep.**
**Nr.** 1977 **Kol.**

# AKT THEMELIMI
# I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR ME ORTAK TË VETËM
# "NILOR FILM" Sh.p.k.

Sot, më datë 30/09/2024 (dymijë e njëzet e kater), përpara meje Zv.Notere Ina Papa, ne baze te autorizimit me Nr.12 Prot., date 24.09.2024 dhe ne baze te urdherit te emerimit me Nr.3950/1Prot., date 16.06.2023 leshuar nga Ministria e Drejtesise , me zyrë në adresën Tiranë, Rruga Vaso Pasha, pallati 13/1 Tiranë, u paraqit personalisht

- **Redi Treni**, i biri i Nikos, shtetas shqiptar, lindur më 23.06.1983, në Tiranë, Shqipëri mbajtës i letërnjoftimit ID me nr. Personal. I30623154K, cel: +355 68 207 0008

i cili ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar me ortak të vetëm (në vijim "**Shoqëria**"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga Statuti i saj.

## Neni 1 - Emërtimi

1.1. Emërtimi i Shoqërisë është "NILOR FILM" Sh.p.k.

## Neni 2 - Selia

2.1. Selia e Shoqërisë është në Tiranë (Shqipëri) në adresën: Rruga "Margarita Tutulani"nr.3 Tiranë, Shqipëri.

## Neni 3 - Kohëzgjatja

3.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është me afat të pacaktuar, duke filluar që nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

## Neni 4 – Objekti i Shoqërisë

4.1. Shoqëria ka si objekt veprimtarie kryesisht, por jo vetëm, veprimtaritë në fushën e prodhimit të filmave, spoteve publicitare, mediave elektronike, televizive, si më poshtë, por pa kufizim:

4.1.1 Konkretisht:

a) Zhvillimin, prodhimin, bashkëprodhimin, shpërndarjen dhe tregtimin në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj të filmave me metrazh të ndryshëm, të serialeve televizive, të dokumentareve, të filmave vizatimorë dhe programeve audio-vizuale në të gjitha format ekzistuese;
b) Prodhimin dhe shpërndarjen e të gjitha spektakleve artistike të skenës dhe të televizionit në Shqipëri dhe jashtë kufijve të saj;

Redi

A2024053540199042695

c) Dublimin, subtitrimin e filmave të huaj dhe shqiptar për vende të tjera;
d) Dhënien e asistencës teknike, artistike dhe organizative të nevojshme për prodhimin e filmave artistikë me metrazh të ndryshëm, të dokumentareve, të filmave vizatimorë, filmave publicitare dhe të programeve audiovizuale (përfshirë skenën dhe televizionin) që do të prodhohen në Shqipëri dhe jashtë saj;
e) Veprimtari në fushën e medias dhe reklamave për përgatitjen dhe prodhimin e spoteve televizive audio dhe video, dokumentare historiko- shkencor dhe turistikë, si dhe për përgatitjen e materialeve figurative për qëllime reklamimi ose informuese.
f) Casting dhe audicion;
g) Dizajnim dhe zhvillim produktesh për internet dhe print;
h) Dizajnim fletëpalosjesh, broshurash, revistash, librash, city lights, billboards dhe çdo gjë që është e lidhur me printimin dhe punët grafike;
i) Ndërtim dhe menaxhim faqesh web dhe të rrjeteve sociale;
j) Shitje artikujsh dhe shërbime promocionale ;
k) Shitje biletash për evente artistike;
l) Konceptim, zhvillim dhe realizim fushatash promocionale sensibilizuese, kulturore dhe turistike;
m) Shitblerja e të drejtave të autorit;
n) Prodhime dhe realizime të shfaqjeve të ndryshme teatrore, artistike, operistike, musical, spektakle të ndryshëm;
o) Shërbim skenografie në film, televizion, spektakël dhe teatër;
p) Aktivitetet e marketingut, menaxhimi i fushatave reklamuese, studimi dhe përgatitja e planeve të zhvillimit tregtar në sektorët e mësipërm;
q) Përgatitjen dhe menaxhimin e laboratorëve për krijimin dhe mirëmbajtjen e produkteve audiovizive dhe kinematografike në përgjithësi si dhe të pajisjeve të nevojshme për shikimin e tyre;
r) Punësimin e artistëve duke përfshirë ekskluzivisht organizimin dhe menaxhimin e shfaqjeve televizive, teatrale apo koncerte.
s) Botimi, prodhimi, riprodhimi dhe shpërndarja e revistave, gazetave, e krijimeve të fjalës të shprehura nëpërmjet shkrimeve letrare, publicistike, shkencore si dhe të çdo krijimi tjetër me shkrim.
t) Zhvillimin e veprimtarive të mësimdhënies në fushën e multimedia.

4.1.2 Gjithashtu, shoqëria ka për objekt edhe veprimtaritë e mëposhtme:

a) Promocionin dhe lidhjen, për llogari të saj dhe të të tretëve, të kontratave publicitare në përgjithësi, me privatë, shoqëri tregtare, ente publike dhe private që janë të interesuar për reklamimin e produkteve në gazeta, revista, broshura, periodikëve, në ekspozita dhe manifestime të çdo lloj natyre, si në Shqipëri, ashtu edhe jashtë saj;
b) Organizimin dhe drejtimin për llogari të të tretëve të zyrave të shtypit lidhur me sektorin kinematografik, televiziv, teatral, manifestimet turistike, sportive dhe të spektaklit në përgjithësi;
c) Ideimin, realizimin, përgatitjen, menaxhimin e eventeve, konferencave, mbledhjeve, prezantimeve, seminareve, performancave, koncerteve, sfilatave, tregjeve, panaireve, ekspozimeve, ekspozitave, instalacioneve, konkurseve.
d) Si dhe në përgjithësi kryerja e çdo aktiviteti tjetër që shoqëria do ta konsiderojë të arsyeshëm.

4.2 Shoqëria do të mund të blejë pjesëmarrje aksionare apo jo aksionare në shoqëri të

A2024053540199042695

tjera, ente, konsortiume, të themeluara apo në themelim, shqiptare ose të huaja, të cilat kanë objekt të ngjashëm apo sidoqoftë të ndërlidhur apo plotësues të objektit të saj, apo sidoqoftë në funksion të arritjes së qëllimeve të shoqërisë.

4.3 Më në përgjithësi, shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari tjetër që, edhe pse nuk ka lidhje me sa është parashikuar më sipër, nuk përbën një veprimtari të ndaluar me ligj dhe që është në funksion të përmbushjes së objektit të shoqërisë.

**Neni 5 – Kapitali themeltar**

5.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 (njëqind) Lekë.

5.2. Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, me një vlerë prej 100 (njëqind) Lekë.

**Neni 6 – Kontributet dhe kuotat**

6.1. Kontributi në kapitalin e Shoqërisë është ofruar si më poshtë:

Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 100 (njëqind) Lekë dhe zotërohet prej Ortakut të vetëm si më poshtë:

- **Redi Treni**, i biri i Nikos, shtetas shqiptar, lindur më 23.06.1983, në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit ID me nr. Personal. I30623154K, i cili është pronar i të gjithë kapitalit të Shoqërisë "NILOR FILM" sh.p.k.

6.2. Sipas kontributeve të mësipërme:

- **Redi Treni** zotëron 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë në formim e sipër.

**Neni 7 – Transferimi i pjesëve të kapitalit**

7.1. Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

**Neni 8 – Administratori**

- Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator, **Redi Treni**, atësia Niko, shtetas shqiptar, lindur më 23.06.1983, në Tiranë (Shqipëri), mbajtës i letërnjoftimit ID me nr. Personal I30623154K, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, me adresë e-maili reditreni@gmail.com, cel: +355682070008, emëruar prej Ortakut të Vetëm, i cili qëndron në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen e tij, apo për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh. Ai mund të rizgjidhet për të njëjtin afat.

8.1. Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i takon Administratorit. Administratori do të kryejë të gjitha aktet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, përjashtuar kompetencat të cilat i përkasin organeve të tjerë të Shoqërisë sipas ligjit të zbatueshëm apo sipas Statutit.

8.2. Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për akte të veçanta ose

A2024053540199042695

për kategori aktesh.

**Neni 9 – Gjuha**

9.1. Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETËM | ZEVENDESNOTERE

PËR "NILOR FILM" SH.P.K.

REDI TRENI | INA PAPA

Redi Treni

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**

**DEGA VENDORE TIRANE**

**NOTERE MIMOZA SADUSHAJ**

---

**Adresa:** Rr. "Vaso Pasha", Pallati 13/1 tel 042266242

**Nr.** 12 **Prot** Tiranë, më 24.09.2024

## AUTORIZIM

Unë, Notere Mimoza Sadushaj, jam anëtare në degën vendore Tiranë, me seli në Rr "Vaso Pasha" Pll.13/1". Autorizoj Znj.Ina Papa, zëvëndësnotere sipas urdhërit me nr. 404, datë 13.06.2023, me të cilën kam lidhur kontratë punë, të kryejë veprimtari noteriale pranë zyrës time, bazuar në nenin 63 pika 2, dhe nenin 66 pika 3, të ligjit "Për Noterinë".

Zëvëndësnoterja Ina Papa, ka të drejtë të nënshkruajë akte noteriale, të kryejë veprime noteriale si dhe procedurat e transaksioneve bankare, nga data 24.09.2024 ora 14:00 deri në 03.10.2024 ora 18:00.

NOTERE

MIMOZA SADUSHAJ